




SISTEMI I AUTOMATIZIMIT TË SPORTELEVE TË POSTËS SË KOSOVËS

POSTA E KOSOVËS

Zyra postare :
Post Office: **PRISHTINA 22 (T1)**
Postanski ured:

Nr. serik :
Serial no. **2064201962804**
Serijski br.

DËFTESË PËR PRANIMIN E DËRGESËS/CERTIFIKATE OF DISPATCH'S ON ADMISSION/POTVRDA O PRIJEMU POSILJKE

| | | | | | |
|---------------------------------------------------------------------|-----------------------------------------------------------------------------------|-------------------------------------------------|---------------------------------------------|--------------------------|------------|
| Dërgesa: Mail: Posiljka | Letrat | Nr. i pranimit: Reception No Prijemni br. | 7539922 | Data: Date: Datum: | 23/08/2019 |
| Marrësi: Recipient: Primalac: | GJYKATA THEMELORE | | | | |
| Adresa e marrësit: Address of the recipient: Adresa primaoca: | PRISHTINE ,Prishtinë | | | | |
| Shtërbime të veçanta: Particular services: Posebne usluge: | AR | | Vlera/Value/Vrednost 0.00 | | |
| Vërtetësinë e shënimeve e vërteton dërguesi: |  | | Kundërpagesa/Counter payment/Otkupnina 0.00 | | |

Pesha
Weight **22.000** Gr
Tezina

Taksa postare
Post. Tax **1.60** €
Postarina



Vërejtje: Të ruhet në rast reklamacioni
Remars: Keep in case of advertising
Napomena: Da se sacuva u slucaju reklamacija

Nënshkrimi
Signature
Potpis


Aida Mehmetaj

POSTA SH. A

28 Nentori Hyrja NR: 4
Prishtinë
Zyra Postare Prishtina.22
Rr: Tring Smajli PN
030 557 200 030 221 631

NR. FISKAL: 600815924
NR. I TVSH: 330165242

KUPON FISKAL

| | |
|---------------------------------------|-------------|
| 00 | OPER. |
| 11000156 # PULLA POSTARE 0.80€ 2*0.80 | 1.60€ |
| Totali pa TVSH | 1.60 |
| Totali €: | 1.60 |
| Para të gatshme : | 1.60 |
| 021041 | ARTIKUJ 1 |
| 23-08-2019 | 11:31 |
| NR. SER. | DG02200229 |

KUPON FISKAL
NR. 4



GJYKATËSIT TË LËNDËS
GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË
DEPARTAMENTI PËR ÇËSHTJE ADMINISTRATIVE
PRISHTINË

PADITËSI: Blerta Morina me numër personal [REDAKTUAR] e përfaqësuar nga Avokatja Rina Kika, me adresë në Rr. Miss Edith Durham B1 Hyrja 1 Nr. 11, 10000 Prishtinë, (sipas autorizimit në shkresat e lëndës)

E PADITURA: Agjencia për Regjistrimin Civil, Ministria e Punëve të Brendshme

DATA: 23 gusht 2019

KËRKESË E PËRSËRITUR PËR PËRSHPEJTIMIN E PROCEDURËS
LIDHUR ME PADINË PËR KONFLIKT ADMINISTRATIV

I/e nderuar/a Z./Znj. Gjykatës/e,

Po ju drejtohem si përfaqësuese e Z. Blert Morina sipas autorizimit në shkresat e lëndës. Me anë të kësaj shkrese, ne përsëri kërkojmë që të përshpejtohet procedura e shqyrtimit të padisë për konflikt administrativ të Z. Blert Morina të dorëzuar me datë **24 korrik 2018** kundër Vendimit Nr. 64-04 të Agjencisë për Regjistrimin Civil. Me këtë vendim është refuzuar kërkesa e Z. Morina për ndërrimin e emrit nga "Blerta" në "Blert" dhe ndërrimin e shënuesit të gjinisë nga "F" në "M".

Deri tani, kemi dërguar gjithsej pesë kërkesa për përshpejtim të procedurës lidhur me padinë për konflikt administrativ. Kërkesat janë dërguar më 4 dhjetor 2018, 22 mars 2019, 16 prill 2019, 5 qershor 2019 dhe 4 korrik 2019.

Gjykata Themelore në Prishtinë, Departamenti për Çështje Administrative, së fundmi ka trajtuar dy raste të ngjashme me rastin e Z. Morina. Në aktgjykimet A. Nr. 2196/2017 të datës 27 dhjetor 2018 dhe A. Nr. 1571/2018 të datës 17 prill 2019, gjykata ka aprovuar kërkesat e paditësve për ndërrimin e emrit dhe shënuesit të gjinisë, duke i anuluar kështu vendimet refuzuese të nxjerra nga Agjencia e Regjistrimit Civil.

Mos-adresimi i këtij rasti brenda një afati të arsyeshëm dhe mos-shqyrtimi me kohë i shkeljeve të të drejtave të njeriut nga Vendimi Nr.64-04 i Agjencisë për Regjistrimin Civil ka për pasojë shkelje të vazhdueshme të së drejtës së privatësisë së Z. Morina.

Prandaj, kërkojmë që ta përshpejtoni shqyrtimin e padisë për konflikt administrativ, ashtu që Z. Morina të gëzojë mbrojtjen e të drejtave të njeriut që i takojnë sipas Kushtetutës, Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, Ligjit për Barazi Gjinore dhe praktikës gjyqësore të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut.

Me respekt,

Rina Kika LL.M.

Avokate

Kika & Associates ShPK

T +383 49 355 722

E rina@kika-associates.com

Rr. Edith Durham B1 H1 Nr.11

10000 Prishtinë

Kosovë

